



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 52.05/Prot.
30

Tiranë, më 12.12.2022

URDHËR

Nr. 211, datë 12.12.2022

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË AKTIVEVE

Në zbatim të ligjit nr. 10296/2010, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, të udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të udhëzimit nr.8, datë 13.03.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, të Statutit dhe Rregullores së brendshme,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve", sipas dokumentit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aurora BALLIU



Konceptoi: A. Alia; E. Meçaj

RREGULLORE PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË AKTIVEVE TË QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave specifike, gjurmëve të auditit dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të QSHA-së, në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

Neni 2

Kategoritë e aktiveve

Nga pikëpamja e menaxhimit, aktivet e QSHA-së ndahen në dy kategori:

- a. Aktivet gjendje në magazinë, si dhe vlerat monetare të arkës;
- b. Të gjitha aktivet e vëna në përdorim brenda QSHA-së.

Neni 3

Përgjegjësitë e punonjësve

1. Punonjësit janë përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit, kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre sipas kompetencave që mbulojnë, duke dokumentuar veprimet e ndërmarra, për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që kanë nën përgjegjësi.
2. Aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi në dokumentacionin përkatës të të dhënave si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim.
3. Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar në urdhrin për përfundimin e marrëdhënieve juridike të punës nga Drejtori i Përgjithshëm.
4. Punonjësi që urdhëron për hyrjen dhe daljen e aktiveve nuk mund të ngarkohet edhe me detyrën e arkëtarit dhe/ose magazinierit.

Neni 4

Përgjegjësitë e GMS

Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në lidhje me menaxhimin e aktiveve dhe riskut të lidhur me to, të evidentuara gjatë takimeve periodike midis drejtorëve dhe përgjegjësve të sektorit, i parashtrihen Grupit për Menaxhimin Strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre.

KREU II

MENAXHIMI I RISKUT TË LIDHUR ME AKTIVET

Neni 5

Përbërja

QSHA-ja duhet të plotësojë planin e vet me një njohje të mirë të bazës së aktiveve që duhen për të përmbushur objektivat e saj. Aktivet duhet të menaxhohen njëjloj si çdo pjesë tjetër e punës, që do të thotë se duhet të ekzistojnë sistemet e kontrollit dhe informimit, për të provuar se mjetet financiare janë shpenzuar me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi.

Neni 6

Masat për kufizimin e humbjeve financiare

Masat për kufizimin e humbjeve financiare përfshijnë:

- a. Mbrojtjen fizike** kundër vjedhjes, vandalizmit, dëmtimeve natyrore, nëpërmjet instalimit të kasafortave, drynave të sigurisë/alarmit/patrullat, sistemit të pompave për parandalimin e zjarrit, kontrollin e inventarëve dhe siguracionet, etj;
- b. Aksesin e kontrolluar dhe ruajtjen** e informacionit mbi aktivet, të dhënat e personelit, të dhënat financiare, sistemet e kompjuterizuara të informacionit, etj.
- c. Depozitimi** në llogaritë e sistemit të thesarit i vlerave monetare të arkëtuara nga QSHA, menjëherë pas pranimit të tyre.
- d. Përcaktimin** e sistemeve dhe procedurave për zëvendësimin apo shtimin e aktiveve afatgjata.
- e. Riparim i menjëhershëm i dëmeve.** Duhet të kryhen inspektime të rregullta dhe të ekzistojë një sistem për regjistrimin e dëmeve dhe për garantimin se veprimet e duhura po merren me shpejtësi.
- f. Shërbime të rregullta mirëmbajtjeje** për minimizimin e avarive të mundshme. Për tu siguruar për efikasitetin e aktiveve është e nevojshme të ekzistojnë sistemet përkatëse të kontrollit.
- g. Mirëmbajtja e planifikuar.** Aktivet afatgjata materiale duhen mbikëqyrur rregullisht në drejtim të jetëgjatësisë së pjesëve përbërëse të tyre (p.sh çatisë, sistemit

të ngrohjes, etj). Në një program mirëmbajtjeje të planifikuar ky informacion përdoret për të orientuar shpenzimet drejt punës parandaluese sesa drejt riparimit të avarive. QSHA harton planin e mirëmbajtjes së aktiveve me qëllim planifikimin e fondeve të nevojshme si dhe sigurimin e efijencës në përdorimin e aktiveve sipas shtojcës nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

- h. Trajnimi** i punonjësve për përdorimin dhe mbrojtjen e aktiveve.
- i. Përshtatshmëria për përdorim** e aktiveve, nëse është e mundur, për minimizimin e riskut që vjen nga mospërputhja e aktivitetit me objektivin në rast të ndryshimit të kushteve të punës.

KREU III

REGJISTRI I AKTIVEVE DHE DOKUMENTIMI I LËVIZJES SË TYRE

Neni 7

Regjistri i aktiveve

QSHA-ja krijon dhe përditëson regjistrin kontabël të të gjitha aktiveve, që zotëron apo ka në administrim. Regjistri mbahet në formën e karteleve ose në formë të sintetizuar.

Neni 8

Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve

1. Veprimet ekonomike që kryhen në QSHA si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.
2. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:
 - a. Dokumente autorizues** - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.
 - b. Dokumente vërtetues** - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.
 - c. Dokumente të kontabilitetit** - janë dokumentet përmbledhës ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitike, kartelat e aktiveve, etj) të çdo lloji forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

3. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve.
4. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë).
5. Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve.
6. Marrja në dorëzim e aktiveve për përdorim nga punonjësit e QSHA-së kryhet në bazë të kërkesës sipas shtojcës nr.2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
7. Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivitetet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme.
8. Magazinieri dorëzon tek përgjegjësi e sektorit të shërbimeve mbështetëse dhe menaxhimit të burimeve njerëzore nga një kopje origjinale për fletë hyrjet, faturën e furnizuesit (shitësit) si dhe fletë daljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë brenda 30 ditëve në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre.

Neni 9

Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara

1. Titullari i QSHA-së miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqëruar, sipas shtojcës nr.3 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
2. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushë sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.
3. Marrja në dorëzim e aktiveve kryhet duke zbatuar të gjitha rregullat e parashikuara në udhëzimin nr.30/2011, i ndryshuar.

Neni 10

Veprimet që kryhen nga strukturat e nëpunësit zbatues

Nëpunësi zbatues dhe strukturat e tij zbatojnë të gjitha rregullat e parashikuara në udhëzimin nr.30/2011, i ndryshuar.

KREU IV

DOKUMENTIMI I VLERAVE MONETARE

Neni 11

Dokumentimi i vlerave monetare

1. Pagesat ndërmjet QSHA-së dhe entiteteve të sektorit privat bëhen nëpërmjet sistemit të thesarit, direkt në llogarinë bankare të përfituesit.
2. Dokumentimi i vlerave monetare kryhet sipas të gjitha rregullave dhe procedurave të parashikuara në udhëzimin nr.30/2011, i ndryshuar.

Neni 12

Listë pagesat

1. Listë pagesat plotësohen nga përgjegjësi i sektorit të shërbimeve mbështetëse dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, duke u mbështetur në të dhënat e listë prezencës të firmosur nga drejtori i drejtorisë ose personi i autorizuar nga titullari. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga Drejtori i Drejtorisë, ose personi i autorizuar nga titullari dhe përgjegjësi i sektorit të shërbimeve mbështetëse dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.
2. Përmbledhja e listë pagesave, e cila shoqëron urdhrin për shpenzimin e pagave, duhet të nënshkruhet nga Nëpunësi Zbatues dhe nga Nëpunësi Autorizues ose i deleguari i tij.
3. Kërkesa për leje firmoset nga punonjësi, konfirmohet nga përgjegjësi i sektorit, drejtori i drejtorisë, përgjegjësi i sektorit të shërbimeve mbështetëse dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, dhe miratohet nga titullari i institucionit, sipas shtojcës nr.4 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
4. Të dhënat për të përcaktuar të drejtën e punonjësit për pagë, kur ai nuk punon për shkak ndërprerjeje në punë jo për fajin e tij, të lejes së zakonshme, të pjesëmarrjes në kurse trajnimi, për paaftësi të përkohshme në punë, për kryerjen e detyrave të tjera shtetërore ose shoqërore, vërtetohen me dokumente të miratuara me akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU V

SISTEMI I KONTROLLIT PERIODIOK TË AKTIVEVE

Neni 13

Inventarizimi i aktiveve

1. Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të QSHA-së, i cili kryhet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr.30/2011, i ndryshuar dhe urdhrave të titullarit të QSHA-së.
2. QSHA kontrollon të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.
3. Titullari i QSHA-së, kur ka dyshime për mashtrime, abuzime, keqpërdorime, vjedhje apo grabitje të aktiveve apo të një pjese të tyre, ose qoftë edhe për të vërtetuar saktësinë e veprimeve ligjore për një periudhë kohore mund të urdhërojë kryerjen e inventarizimeve të plota apo të pjesshme, pa kufizim në numër jashtë afateve të parapara të inventarizimit të aktiveve.
4. Inventarizimi kryhet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr.30/2011, i ndryshuar.

Neni 14

Përgjegjësitë për inventarizimin

1. Inventarizimi kryhet nga një komision i posaçëm që krijohet me urdhër të titullarit të QSHA, sipas shtojcës nr.5 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
2. Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga Nëpunësi Zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të QSHA-së.
3. Komisioni nuk duhet të jetë më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi dhe, në mungesë të tij, zbatohen kriteret e përcaktuara në udhëzimin nr.30/2011, I ndryshuar.
4. Inventarizimi kryhet sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në udhëzimin nr.30/2011, i ndryshuar.
5. Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbalit të mbajtur midis përgjegjësit të materialeve dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës sipas shtojcës nr.6 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit të materialeve.
6. Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision.
7. Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për:

- a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të QSHA-së dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në proceverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit.
 - b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.
 - c. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.
8. Personat e ngarkuar për kryerjen e inventarizimeve mbajnë sipas rastit përgjegjësi disiplinore, materiale a penale për moskryerjen me saktësi të inventarit.
 9. Nëpunësi Autorizues me të marrë dokumentacionin e inventarizimit, nxjerr urdhrin për ndjekje nga Nëpunësi Zbatues në lidhje me masat për kompensimin dhe sistemimin e diferencave të rezultuara.
 10. Mungesat dhe tepricat në artikuj të veçantë të aktiveve mund të kompensohen ndërmjet tyre në këto raste:
 - a. kur janë në sasi dhe vërtetohet se ndërmjet tyre ka lidhje shkakësore (në të njëjtin inventar);
 - b. në raste të tjera të veçanta (ndërmjet dy inventarëve të njëpasnjëshëm), kur vërtetohet se ka lidhje shkakësore ndërmjet tyre (kur diferenca është pasojë e pasaktësisë së inventarit të mëparshëm);
 - c. kur tepricat e mungesat që janë gjetur në persona të ndryshëm me përgjegjësi materiale, kanë lidhje shkakësore ndërmjet tyre dhe dalin nga inventarizimet e kryera njëkohësisht në të dy punonjësit me përgjegjësi materiale.
 11. Në rast se pas inventarizimit dalin ndryshime në vleftë, mungesa mbetet në ngarkim të punonjësit me përgjegjësi materiale, kurse tepricat bëhen hyrje në magazinë dhe shkojnë në dobi të QSHA-së.
 12. Mungesat përtej normave të firove ligjore, prishjet dhe dëmtimet e aktiveve që u ngarkohen fajtorëve, vlerësohen si vijon:
 - a. Aktivet në magazinë në bazë të çmimit të shitjes me pakicë, dhe, kur nuk ka të tillë, në bazë të kostos së blerjes;
 - b. inventari i imët në përdorim dhe ambalazhi jo me pak se 50% të çmimit të blerjes ose të kostos.
 - c. aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale në bazë të vleftës bruto (vlefata fillestare dhe shpenzimet e mëpasshme të aktivitetit) të pakësuar me amortizimin efektiv, ose vlerës së drejtë por jo më pak se 50 % të çmimit të blerjes ose të vlerës bruto.

12. Në rast se punonjësi me përgjegjësi materiale ka kundërshtim për rezultatet e inventarizimit, për gjendjen fizike, cilësinë dhe çmimin, kërkesa e tij shqyrtohet nga Nëpunësi Autorizues pas përfundimit të inventarizimit.
13. Në rast se pranohen si të drejta këto kundërshtime, komisioni i inventarizimit, pasi i verifikon, bën ndreqjet përkatëse. Kur ka bazë të mjaftueshme dhe nëse magazina nuk është hapur pas përfundimit të inventarit, me urdhër të titullarit, bëhet inventarizimi i dytë dhe shpenzimet e bëra përballohen nga persona që kanë kryer inventarin e pasaktë.
14. Nëpunësi autorizues i QSHA-së jep urdhër zhdëmtimin për mungesat e konstatuara në ngarkim të personave me përgjegjësi materiale. Nëpunësi zbatues ndjek procesin dhe kryen rregjistrimet kontabël përfundimtarë.

Neni 15

Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuar për dalje nga përdorimi

1. Ky është një proces që kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në udhëzimin nr.30/2011, i ndryshuar.
2. Procesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi.
3. Komisioni i vlerësimit ngrihet me miratim të titullarit sipas shtojcës nr.7 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje. Nëpunësi Autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit.
4. Në të gjitha rastet komisioni i vlerësimit të aktiveve ka përbërje tjetër nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi në njësi të aktiveve.
5. Komisioni i vlerësimit dhe komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përgjigjen për zbatimin e ligjshmërisë dhe të kriterëve të miratuara në udhëzimin nr.30/2011, i ndryshuar
6. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 persona të cilët janë menaxherë ose specialistë të financës si dhe specialistë të fushës përkatëse sipas natyrës së aktiveve që propozohen për dalje nga përdorimi. Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nëpunësi Zbatues i QSHA-së. Nëpunësi/punonjësi me përgjegjësi materiale të jetë i pranishëm gjatë procesit të vlerësimit, por jo në përbërje të komisionit.
7. Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se 5 vetë, kryetari i këtij komisioni përcaktohet nga titullari dhe anëtarët përcaktohen nga kryetari, në vartësi të kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të dhëna në udhëzimin nr.30/2011, i ndryshuar. Ky komision ngrihet me miratim të titullarit sipas shtojcës nr.8 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 16

Lista e aktiveve të identifikuara për vlerësim

1. Nëpunësi Zbatues i QSHA-së, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve te rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/ përfitimin për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marrë mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të QSHA-së, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen.
2. Lista nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tre kopje, një nga të cilat një kopje qëndron në arkiv.

Neni 17

Kriteret për vlerësimin e aktiveve

1. Vlerësimi i Aktiveve bëhet sipas këtyre kriterëve:
 - a. kur është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen;
 - b. kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër;
 - c. kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit;
 - d. kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm.
 - e. kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formën tjetër;
 - f. kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë;
 - g. kur janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e fuqisë madhore (tërmet, përmbytje, zjarr etj.) ose ndodhive të rastit;
 - h. kur si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës, misionit të QSHA-së, objektivave afatmesme ose afatgjate nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje.

Neni 18

Procesverbali i vlerësimit

1. Procesverbali i vlerësimit hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre:
 - a. nëse është i nevojshëm apo jo për veprimtarinë e QSHA-së;
 - b. nëse nuk rezulton i nevojshëm për QSHA-në, a është në gjendje të mirë fizike dhe ka mundësi përdorimi të mëtejshëm në njësi të tjera;
 - c. nëse duhet të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar.
2. Procesverbali hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Procesverbali miratohet nga titullari i QSHA-së.

Neni 19

Relacioni i vlerësimit

Relacioni përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit.

Neni 20

Dhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve

1. Aktivet afatgjata që pas vlerësimit konsiderohen të panevojshme përkohësisht për QSHA-në në një periudhë të mëvonshme të funksionimit të saj (në rast ndryshimi të objektivave afatmesme ose afatshkurtër të QSHA-së), por që mbeten në gjendje përdorimi, mund të jepen në përdorim të përkohshëm sipas përcaktimeve të udhëzimit nr.30/2011, i ndryshuar.
2. Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, gëpusur ose djegur.

Neni 21

Procesverbali për dhënien në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve

Procesverbali hartohet nga komisioni për nxjerrjen nga përdorimi në tre kopje, ku përshkruhet procedura e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv lidhur me dhënien në përdorim ose tjetërsimin e tyre, ose nxjerrjen jashtë përdorimit dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve, dhe nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e komisionit.

Neni 22

Përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme

Të gjitha aktivet dhe pajisjet e panevojshme nxirren nga përdorimi me miratimin e titullarit të QSHA-së.

KREU VI

GJURMËT STANDARDE TË AUDITIT

Neni 23

Gjurmët standarde të auditit

1. Gjurmët standarde të auditit paraqiten bashkëlidhur dhe janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje
 - a. Gjurmët për menaxhimin e aktiveve sipas përgjegjësive, sipas shtojcës nr.9 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje;
 - b. Gjurmët për inventarizimin fizik të aktiveve, sipas shtojcës nr.10 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje;
 - c. Gjurma për marrjen në dorëzim të aktiveve, sipas shtojcës nr.11 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje;
 - d. Gjurma për vlerësimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, sipas shtojcës nr.12 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Shtojca nr.1**Plani i mirëmbajtjes së Aktiveve të Qëndrueshme**

Aktivet						Shërbimet periodike	
Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi	Vlera fillestare	Viti i vënies në shfrytëzim	Periodha	Kosto e planifikuar
1							
2							
3							
4							
5							

Shtojca nr.2

Kërkesë për materiale/Urdhër Dorëzimi

Nr. _____,

Datë _____

**Sektorit të Shërbimeve
Mbështetëse dhe Menaxhimit
të Burimeve Njerëzore
(SHBMBNJ)**

Spektori _____

Drejtoria _____

Jepini: z/znj _____

Për llogari _____

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Sasia me shkrim

Financieri

SHMMBNJ

**Marrësi i Urdhër
Dorëzimit**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.202_

URDHËR

Nr __, Datë: __.__.202_

PËR

NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR MARRJEN NË DORËZIM TË MALLRAVE

Mbështetur në Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr., 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.8, datë 13.03.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, dhe kontratën e nënshkruar ndërmjet AK "Qendra e Shërbimeve Arsimore" dhe Kontraktuesit _____, me nr. ____ prot., datë _____,

URDHËROJ

1. Të ngrihet Grupi i Punës, për marrjen në dorëzim të mallrave "_____" me përbërje sa më poshtë:

- | | |
|----------|---------|
| a) _____ | Kryetar |
| b) _____ | Anëtar |
| c) _____ | Anëtar |
| d) _____ | Anëtar |
| e) _____ | Anëtar |

2. Grupi i Punës kontrollon nëse mallrat janë në përputhje me specifikimet teknike të caktuara në ftesën për ofertë dhe pranojnë me procesverbal marrjen në dorëzim të tyre, në zbatim të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në kontratë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Shtojca nr.4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. Prot.

Tiranë, më _____.____.202_

Lënda: Kërkesë për miratimin e pushimeve vjetore të paguara

Drejtuar: _____
Drejtori i Përgjithshëm

KËTU

E nderuar Z/Znj. _____,

Në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.568, datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr., 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, Urdhrit të Kryeministrit nr. 146, datë 28.09.2018, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore", me anë të kësaj kërkesë, Ju drejtohem për miratimin e ndryshimit të datave të pushimeve vjetore për vitin _____.

Sa më sipër, lutemi të miratoni këtë kërkesë, për periudhën _____, deri më _____. Me datë _____ do të paraqitem në punë.

Me respekt,

Specialisti. _____

Pranohet:

Përgjegjës Sektori _____

Drejtori i Drejtorisë

Miratohet:

Drejtori i Përgjithshëm

Bulevardi "Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë

www.qsha.gov.al
Aurora.Balliu@qsha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. Prot.

Tiranë, më _____._____.202_

URDHËR

Nr ____ datë ____ . ____ .202_

PËR

NGRITJEN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN
DHE VLËRËSIMIN E AKTIVEVE

Mbështetur në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, paragrafi 97, i udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve, në njësitë e sektorit publik”, VKM Nr.1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, i ndryshuar,

urdhëroj:

1. Ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të instaluar dhe në përdorim të QSHA-s, në godinën me adresë Bulevardi Zhan D’Ark, nr.23, Tiranë, me përbërje si më poshtë:
 - _____ Kryetar
 - _____ Anëtar
 - _____ Anëtar
2. Komisioni ngarkohet të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve/pajisjeve të instaluar e në përdorim dhe aktivet/pajisjet të cilat për shkak të jetëgjatësisë, janë hequr nga përdorimi e janë në ruajtje në të njëjtën godinë.
3. Komisioni kryen inventarizimin në prani të punonjësve të zyrës dhe plotëson fletë inventarizimit, (sipas formatit bashkëlidhur) për secilin ambient/zyrë me emrat dhe firmat e komisionit dhe personave përgjegjës të zyrës. Në përfundim të procesit të inventarizimit komisioni përpilon procesverbalin përmbledhës përkatës, cili firmoset nga të gjithë anëtarët e grupit dhe dorëzohet pranë zyrës së financës, i shoqëruar me fletët e inventarizimit edhe në kopje elektronike (excel).
4. Afati për mbylljen e procesit të inventarizimit data _____._____.202_

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Shtojca nr.6



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT**

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. Prot.

Tiranë, më _____.____.202_

PROCES VERBAL

I mbajtur sot më datë _____.____.202_ pranë magazinës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore nga komisioni i inventarizimit, në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. ____, datë _____.____.202_ “për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve” në prani të punonjësit materialisht përgjegjës, z/znj. _____, për nisjen punës për inventarizimin e magazinës.

Numri i fundit i hyrjes në magazine: nr. _____, datë _____.____.202_

Numri i fundit i daljes nga magazina: nr. _____, datë _____.____.202_

Komisioni

P/materialisht përgjegjës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. Prot.

Tiranë, më _____.____.202_

URDHËR

Nr. ____ datë ____ . ____ .202_

PËR

NGRITJEN E KOMISIONIT PËR VLËRËSIMIN E AKTIVEVE
PROPOZUAR PËR NXJERRJE JASHTË PËRDORIMIT

Mbështetur në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, paragrafi 97, i udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve, në njësitë e sektorit publik”, VKM Nr.1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, i ndryshuar,

urdhëroj:

1. Ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve aktivet/pajisjet të cilat për shkak të jetëgjatësisë, apo defekteve janë hequr nga përdorimi e janë në ruajtje në ambientet e QSHA-s, në godinën me adresë Bulevardi Zhan D’Ark, nr.23, Tiranë, me përbërje si më poshtë:
 - _____ Kryetar
 - _____ Anëtar
 - _____ Anëtar
 - _____ Anëtar
 - _____ Anëtar
2. Komisioni ngarkohet të kryejë vlerësimin e të gjitha aktiveve/pajisjeve të cilat për shkak të jetëgjatësisë, apo defekteve, janë hequr nga përdorimi e janë në ruajtje në të njëjtën godinë.
3. Komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të gjitha aktiveve ngarkohet të hartoj procesverbal për secilin aktiv individualisht, duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre. Procesverbalet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë të dhënat e aktivitetit dhe vlerësimin përkatës, si dhe propozimin për trajtimin e mëtejshëm të tyre.
4. Afati për mbylljen e procesit të vlerësimit të aktiveve data _____.____.202_.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. Prot.

Tiranë, më _____.____.202_

URDHËR

Nr ____ datë ____ . ____ .202_

PËR

NGRITJEN E KOMISIONIT PËR NXJERRJE
JASHTË PËRDORIMIT TË AKTIVEVE

Mbështetur në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, paragrafi 97, i udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve, në njësitë e sektorit publik”, VKM Nr.1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, i ndryshuar,

urdhëroj:

1. Ngritjen e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, aktivet/pajisjet të cilat për shkak të jetëgjatësisë, apo defekteve janë hequr nga përdorimi, janë vlerësuar si të papërdorshme e janë në ruajtje në ambientet e QSHA-s, në godinën me adresë Bulevardi Zhan D’Ark, nr.23, Tiranë, me përbërje si më poshtë:

- _____ Kryetar
- _____ Anëtar
- _____ Anëtar
- _____ Anëtar
- _____ Anëtar

2. Komisioni ngarkohet të kryejë nxjerrjen nga përdorimi, të aktiveve që janë në magazinë dhe në ngarkim të punonjësve.
3. Komisioni ngarkohet të hartoj procesverbalin përkatës të kryerjes së procesit të nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve dhe në përfundim të tij të firmoset nga të gjithë anëtarët.
4. Afati për mbylljen e procesit të nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve data _____.____.202_.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Shtojca nr.9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

**GJURMËT E AUDITIT PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE SIPAS
PËRGJEGJËSIVE**

